



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT TË PERGJITHSHEM / KANCELARIJA GENERALNOG
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

Nr i dok. 23.12.1-2010-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR FUND VITIN 31 DHJETOR 2010
TË KOMPANISË SË UJËSJELLËSIT RAJONAL “HIDRODRINI”
SH.A. PEJË**

Prishtinë, Qershor 2011

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
I. Hyrje.....	5
II. Opinioni i auditimit	7
III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara.....	7
IV. Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Shpenzuar.....	8
V. Pasqyrat financiare	11
V.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm	11
V.2 Cilësia e informatave.....	11
VI. Realizimi i Buxhetit.....	12
VI.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetanake).....	12
VI.2 Shpenzimet	13
VI.3 Pasuritë dhe Borxhet	15
VII. Kontrolli mbi menaxhimin	19
VII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm.....	19
VII.2 Auditimi i Brendshëm	20
VIII. Konkluzion i Përgjithshëm.....	21
Shtojca I. Komentet e KUR Hidrodrini dhe përgjigjja e ZAP-it	22
Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit.....	23

Lista e shkurtesave

AB	Auditimi i Brendshëm
AP	Auditori i Përgjithshëm
AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
LPP	Ligji nr.02/L-99 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar më 8 shkurt 2007. Përfshirë ligjin e ri, nr. 03/L-241 në fuqi prej 01 dhjetor 2010.
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrollat
MZHE	Ministria për Zhvillim Ekonomik
NP	Ndërmarrje Publike
OE	Operatori Ekonomik
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit(INTOSAI)
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
SNK	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNRF	Standardet Ndërkombëtare për Raportim Financiar
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
KUR	Kompania e Ujësjetës Rajonal

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e pasqyrave vjetore financiare (PVF) të Kompanisë së Ujësjetës Rajonal (KUR) "Hidrodrini" për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA), të hartuara nga INTOSAI (SNISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me PVF-të.

Gjatë formulimit të opinionit ne vlerësuam mjaftueshmërinë e prezantimit të informacionit në pasqyrat financiare.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë me përjashtim të:

- Vlera e pasurisë e prezantuar në bilancin e gjendjes nuk reflekton gjendjen reale. Pasuria në vlerë 3,610,098€ nuk është në pronësinë e kompanisë (këto prona janë në pronësi të: Komunave, KEK-ut, Hekurudhave, Pylltarisë, Private dhe të pa definuara). Po ashtu në bilancin e gjendjes nuk janë prezantuar stoqe, derisa në pasqyrën e shpalosjeve kishte prezantuar stoqe në vlerë 833,101€

(ISSAI 400: *Opinion i kualifikuar*)

Auditimi ynë ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto dobësi janë të përshkruara më detalishtë në brendësi të raportit.

Kompania ka humbje të mëdha të ujit të prodhuar afro 72% dhe nuk kishte bërë analiza të mjaftueshme për shkakun e këtyre humbjeve. Përpos humbjeve ata nuk kanë inkasim të kënaqshëm për ujin e faturuar. Të menaxhimi i shpenzimeve po ashtu janë vërejtur dobësi të theksuara. Prokurimet nuk janë realizuar në pajtim të plotë me kornizën ligjorë të LPP-së. Dosjet e personelit nuk janë komplete si dhe nuk kishte transparence të plotë gjatë rekrutimit të stafit.

Auditori i Brendshëm kishte bërë disa rekomandime në raportet e finalizuara të cilat lidhen me disa fusha të menaxhimit financiar. Menaxhmenti nuk kishte marrë masa lidhur me adresimin e këtyre rekomandimeve.

Me qëllim që të përmirësohet menaxhimi financiar dhe kontrollit të brendshëm ne rekomandojmë Bordin që ti caktojë menaxherit detyrën për rishikimin e procedurave aktuale të Menaxhimit Financiar dhe Kontrolleve (MF/K) dhe të krijojë një pako të re të udhëzuesve në MF/K. Kjo pako duhet të dorëzohet Bordit jo më vonë se 1 shtatori i këtij viti. Duke e bërë këtë, drejtori duhet të vendosë theks të veçantë në:

- Të dhëna të sakta për pasuritë dhe prezantim të drejtë të tyre në PVF;
- Angazhime shtesë për inkasimin e të hyrave të tyre;
- Menaxhim të shpenzimeve në përputhje të plotë me kornizën ligjore;
- Bordi duhet gjithashtu të marrë masa për të analizuar shkakun e humbjes së ujit;
- Transparence gjatë rekrutimit të stafit, si dhe kompletimin e dosjeve të personelit; dhe
- Adresimin e rekomandimeve të auditorit.

Bordi i KUR Hidrodrini i ka pranuar të gjeturat dhe konkluzionet tona në raportin e auditimit për pasqyrat financiare të vitit 2010, dhe është zotuar se do të bëjë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

I. Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me PVF-të e KUR Hidrodrini për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Është përgjegjësi e KUR Hidrodrini të përgatisë PVF-të në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Raportimin Financiar në bazë të parimit akrual të Kontabilitetit.

Bordi i KUR Hidrodrini deri në fund të vitit 2010 ishte përgjegjëse para Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF), ndërsa nga viti 2011 përgjigjet para Ministrisë për Zhvillim Ekonomik (MZHE), si përfaqësuese të pronarit (Republikës së Kosovës).

Ndërsa Qeveria nëpërmjet Ministrit përgjegjës i përgjigjet Kuvendit në baza vjetore lidhur me performancën e NP-ve Qendrore dhe Rajonale.

Auditimi i rregullsisë përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF-ve dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse PVF-të japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne fillimisht kemi kryer auditimin e përkohshëm të KUR Hidrodrini. Në këtë fazë të procesit të auditimit, kemi adresuar faktin se si kemi trajtuar rekomandimet e mëparshme si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Lidhur me këtë ne kemi ofruar këshilla për menaxhmentin e KUR Hidrodrini përmes memorandumit të auditimit të dorëzuar në dhjetor të vitit 2010.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave tona për auditimin e KUR Hidrodrini, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar PVF-të e KUR Hidrodrini në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2010;
- Kemi përcaktuar nëse PVF-të, e KUR Hidrodrinit janë përgatitur në pajtim me SNRF “Standardet Ndërkombëtare për Raportim Financiare”;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të të hyrave dhe shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi PVF-të;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer teste substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
- Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në KUR Hidrodrini.

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi PVF-të për vitin 2010.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për PVF-të e KUR Hidrodrini, SNA përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 2.

II. Opinioni i auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrim të drejtë dhe të vërtetë me përjashtim të:

- Vlera e pasurisë e prezantuar në bilancin e gjendjes nuk reflekton gjendjen reale. Pasuria në vlerë 3,610,098€ nuk është në pronësinë Kompanisë (këto prona janë në pronësi të: Komunave, KEK-ut, Hekurudhave, Pylltarisë, Private dhe të pa definuara). Po ashtu në bilancin e gjendjes nuk janë prezantuar stoqe, derisa në pasqyrën e shpalosjeve kishte prezantuar stoqe në vlerë 833,101€

(ISSAI 400: *Opinion i kualifikuar*)

III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Vitin e kaluar KUR Hidrodrini ishte audituar nga kompania private e auditimit “Universum Audit”. Kjo kompani në raportin e auditimit ka kualifikuar opinionin për një seri të gjeturash siç janë:

- Inkasimi i ulët i të hyrave që mund të këtë ndikim në kryerjen e obligimeve të kompanisë;
- Menaxhimi i pasurive dhe zhvlerësimi i tyre; dhe
- Njohja e provizioneve për borxhet e këqija pa i përmbushur kriteret në pajtim me kornizën ligjore.

Universum Audit ka përgatitur edhe një letër të menaxhmentit në të cilën ka dhënë shtatë rekomandime për përmirësimin e menaxhimit financiar në KUR Hidrodrini.

KUR Hidrodrini ka adresuar tri rekomandime:

- Paraqitja e pasurisë në bazë të kostos historike;
- Ndarja e punëve në mes të faturistit dhe arkëtarit; dhe
- Nxjerrja e procedurave dhe politikave të kontabilitetit.

Rekomandimet të cilat janë në proces të adresimit janë:

- Prezantimi i shpalosjeve në pasqyrat financiare;
- Menaxhimi i parasë të gatshme; dhe

- Për forcimin e kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi i cili nuk ishte adresuar ishte:

- Rangimi i llogarive të arkëtueshme sipas vjetërsisë.

Rekomandimi 1

Ne rekomandojmë Bordin e KUR Hidrodrinit të siguroj:

- Që Drejtori të marrë masa, të adresoj të gjitha rekomandimet duke deleguar detyra dhe veprime konkrete tek personat përgjegjës, përfshirë afatet kohore për kryerjen e tyre.

IV. Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Shpenzuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Shpenzuar tregon:

Tabela 1: Raporti i rezultateve

Përshkrimi	Buxheti Final 2010	Shpenzimet 2010	Shpenzimet 2009	Ndryshimi 2010/2009
Të hyrat nga shitja	2,610,000	2,508,679	2,290,485	218,194
Të hyrat nga grantet	-	92,406	203,191	(110,785)
Të hyrat tjera operative	24,000	180,831	67,045	113,786
Të hyrat nga grantet për blerjen e asetëve	-	221,138	-	221,138
I. Gjithsej të hyrat	2,634,000	3,003,054	2,560,721	442,333
Shpenzimet e pagave	840,000	908,575	832,016	76,559
Mirëmbajtja dhe riparimet	123,600	119,229	114,091	5,138
Energjia elektrike	288,000	339,443	311,342	28,101
Shpenzimet e derivateve	42,000	51,823	43,561	8,262
Provizioni për borxhet e këqija	-	599,542	639,311	(39,769)
Shpenzimet e kemikaleve	4,800	9,996	10,356	(360)
Shpenzimet e jashtëzakonshme	-	12,248	37,156	(24,908)
Shpenzimet tjera operative	81,600	97,160	130,960	(33,800)
Shpenzimet e zhvlerësimit	-	1,100,822	1,019,423	81,399
II. Gjithsej Shpenzimet	1,380,000	3,238,838	3,138,216	100,622
Fitimi/ (Humbja) para tatimit	1,230,000	(235,784)	(577,495)	(341,711)
Tatimi në fitim	-	-	-	-
Fitimi (Humbja) e viti	1,230,000	(235,784)	(577,495)	(341,711)

Të hyrat e planifikuara për KUR Hidrodrini për vitin 2010 ishin 2,634,000€ Planifikimi ishte bërë vetëm për të hyrat vetanake, duke mos planifikuar të hyrat tjera nga grantet (grantet për

shpenzime dhe investime kapitale). Andaj ekziston një diference 369,054€ në raport me të hyrat e realizuara.

Në kolonën e dytë të tabelës, janë paraqitur shpenzimet në vlerë 3,238,838€ që tregon një rritje nga buxheti i planifikuar për 1,858,838€

KUR Hidrodrini nuk kishte bërë planifikim të mirë për shpenzimet e saj. Diferenca rrjedhë kryesisht nga mos planifikimi i shpenzimeve për borxhet e këqija dhe shpenzimeve të zhvlerësimit.

Nga tabela vërehet se humbjet e KUR Hidrodrini ishin më të ulëta në vitin 2010 krahasuar me vitin 2009. Këto të hyra janë rritur me 442,333€ Në të njëjtën kohë shpenzimet janë rritur me rreth 100,000€ Ky është një rezultat negativ dhe një çështje shumë shqetësuese.

Tabela 2: Pamja e Bilancit të gjendjes

Përshkrimi	Realizimi 2010	Realizimi 2009	Ndryshimi 2010/2009
Pasuritë jo qarkulluese: Prona, impiantet dhe pajisjet	15,199,229	19,652,190	(4,452,961)
Pasuritë qarkulluese:			
Stoqet Neto	0	229,031	(229,031)
Llogarit e Arkëtueshme dhe kërkesat tjera	4,174,846	3,807,882	366,964
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	323,540	314,435	9,105
Totali i pasurive	19,697,615	24,003,538	(4,305,293)
Kapitali dhe rezervat	15,596,509	20,743,480	(5,146,971)
Fitimi (Humbja) e akumuluar	(1,088,538)	(511,043)	(577,495)
Fitimi (Humbja) e vitit	(235,783)	(577,495)	341,712
Totali i ekuitetit	14,272,188	19,654,942	(5,382,754)
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	292,318	313,518	(21,200)
Tatimet e pagueshme	1,582,663	1,435,502	147,161
Të hyrat e shtyera	3,535,163	2,584,858	950,305
Detyrimet tjera afatshkurtëra	15,282	14,719	563
Totali i detyrimeve	5,425,426	4,348,597	1,076,829
Totali i ekuitetit dhe detyrimeve	19,697,614	24,003,539	(4,305,925)

Nga pasqyra e bilancit të gjendjes vërehet diferencë e madhe në mes të vitit 2010 dhe vitit 2009. Diferenca ishte si pasojë e ndarjes së njësisë operative të Deçanit e cila ishte bërë me vendim të Bordit të Drejtorëve. Kjo vërehet sidomos te pasuritë fikse në vlerë 4,452,961€ dhe tek ekuiteti i pronarit në shumën prej €5,146,971.

Në anën tjetër, detyrimet e kompanisë në vitin 2010 ishin rritur në shumën prej €1,076,829. Kjo rritje domethënëse vërehet tek të hyrat e shtyera.

Mos prezantimi i stoqeve në PVF

KUR Hidrodrini gjatë vitit 2010 nuk kishte prezantuar stoqe. Ne ekzaminuam dy depo në Pejë dhe vërejtëm se kishte stoqe. Po ashtu në shpalosje janë prezantuar stoqe në vlerë 833,101€ Andaj ky zë nuk ishte prezantuar drejtë në pasqyra financiare të vitit 2010.

Mos harmonizimi me kornizën ligjore të tatimeve

Politika kontabël të KUR Hidrodrinit lidhur me kalkulimin dhe pagesën e tatimeve nuk janë në pajtim me kornizën ligjore të tatimeve (Ligji mbi tatimin e të ardhurave të korporatave Nr.03/L-162). Mospajtimet po i shpalosim në vijim:

- Shpenzimet e borxheve të këqija dhe të dyshimta (Sipas ligjit të tatimit në të ardhurat e korporatave kërkohen të plotësohen disa kushte që të njihet një borxh i keq, ndërsa sipas politikave kontabël të KUR Hidrodrinit këto borxhe kalkuloohen në 60% të të hyrave që nuk janë inkasuar); dhe
- Shpenzimet e zhvlerësimit (Sipas ligjit të tatimit në të ardhurat e korporatave për të njohur shpenzimet e zhvlerësimit duhet të ekzistojnë dëshmitë për koston e pasurisë, ndërsa KUR Hidrodrini ka kalkuluar këto shpenzime duke u bazuar në vlerësimin e pasurive nga një kompani e jashtme e auditimit e kontraktuar nga AKM-ja).

Konkluzioni

KUR Hidrodrini kishte një rezultat me të mirë financiar gjatë vitit 2010 (reduktimi i humbjeve për 341,711€). Megjithatë, ne kemi vërejtur që detyrimet e kompanisë janë në rritje.

Te menaxhimi financiar dobësitë janë vërejtur sidomos të planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve. Mungesa e planifikimit të mirë mund të këtë ndikim në orientimin e rezultateve të kompanisë.

Për qëllime të tatimit KUR Hidrodrini nuk ka korrigjuar pasqyrat e saj. Si pasojë mund të paguaj ndëshkime në të ardhmen.

Rekomandimi 2

Ne rekomandojmë Bordin e KUR Hidrodrinit të siguroj:

- Përmirësim të vazhdueshëm të performancës dhe orientim drejt rezultateve më të mira;
- Kompania të bëjë një planifikim më të mirë të të hyrave dhe shpenzimeve; dhe
- Që në fund të çdo viti janë korrigjuar pasqyrat financiare për qëllime të tatimit.

V. Pasqyrat financiare

V.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm

Bazuar në kërkesat e SNK-ve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar:

- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar nga Menaxhmenti dhe Zyrta e Kryesor Financiar; dhe
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në MEF.

V.2 Cilësia e informatave

Pasaktësitë në vijim nuk janë korrigjuar nga ana e Menaxhmentit dhe për këtë ne po i raportojmë ato në pajtim me ISSAI 1260:

- Pasqyra e shpalosjeve nuk është shume e qartë (për disa zëra nuk korrespondon me zërat e pasqyrës së bilancit të gjendjes);
- Regjistri kontabël i pasurisë nuk është i plotë dhe i saktë (Lista përmbante vlerën e pasurive 3,610,098€ e cila nuk është në pronësi të Kompanisë); dhe
- Nuk janë prezantuar stoqet në pasqyrën e bilancit të gjendjes.

Konkluzioni

Kompania nuk kishte arritur të përgatisë pasqyrat financiare në pajtim të plotë me SNK-të. Disa zëra që kanë ndikim material nuk janë prezantuar dhe shpalosur drejtë në pasqyra financiare.

Rekomandimi 3

Ne rekomandojmë Bordin e KUR Hidrodrinit të siguroj:

- Të dhëna të sakta lidhur me gjendjen financiare si dhe prezantim të drejtë të tyre në pajtim me SNK-të.

VI. Realizimi i Buxhetit

VI.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetanake)

Të hyrat vetanake të KUR Hidrodrini për vitin 2010 janë 3,003,054€ Prej tyre 2,508,679€ janë të hyra nga shërbimet e ujit dhe kanalizimit, 313,544€ janë të hyra nga grantet dhe 180,831€ janë të hyra tjera operative.

Në auditimin e të hyrave kryesisht jemi fokusuar në të hyrat nga shërbimet e ujit dhe kanalizimit. Kemi testuar dhe analizuar sistemin e faturimit dhe barazimin me inkasantë. Po ashtu në detaje kemi testuar 17 mostra duke u bazuar në regjistrin e konsumatorëve.

Mostrat tona kanë shpalosur parregullsitë të cilat i kemi paraqitur në vijim:

Humbjet e ujit të prodhuar janë rreth 72%

Kompania ka humbje të mëdha të ujit të prodhuar, pasi vetëm rreth 28% e ujit të përpunuar arrihet të faturohet. Po ashtu mungon një analizë e mirë lidhur me shkakun e këtyre humbjeve dhe masat të cilat duhet të merren për zvogëlimin e tyre.

Numër i lartë i konsumatorëve të cilët nuk kanë ujëmatës (faturim paushall)

Prej 33,384 konsumatorëve të regjistruar nga kompania, 4,487 ose mbi 13% nuk posedojnë ujëmatës, të cilët faturohen në mënyrë *paushalle*. Vlera financiare e këtyre faturimeve është në vlerë 149,995€

Inkasimi i ulët për ujin e faturuar

Përpos humbjeve të mëdha të ujit kompania kishte edhe realizim të ulët për të hyrat e faturuara. Gjatë vitit 2010 inkasimi ishte 1,510,016€ ose afër 60%.

Konkluzioni

Kompania nuk ka afarizëm të qëndrueshëm financiar. Humbjet e mëdha të ujit dhe inkasimi i ulët mund të rrezikojnë vijimësinë e saj. Humbjet e ujit vijnë si pasojë e rrjetit të dobët, kyçjeve ilegale si dhe faturimeve paushalle.

Rekomandimi 4

Ne rekomandojmë Bordin e KUR Hidrodrinit të siguroj që:

- Janë bërë përpjekje të mjaftueshme lidhur me zvogëlimin e humbjeve të ujit;
- Të gjithë konsumatorët të pajisen me ujëmatës dhe që faturimi të bazohet në ujin e shpenzuar nëpërmjet ujëmatësve; dhe
- Të shtoj angazhimin në rritjen e shkallës së inkasimit të të hyrave.

VI.2 Shpenzimet

2.1 Blerjet përmes prokurimet

KUR Hidrodrini kishte planifikuar prokurime në vlerë prej 272,800€ Prej tyre kishte realizuar 165,618€ ose 61%.

Në kuadër të këtyre shpenzimeve ne kemi testuar tetë mostra (dy mostra nga kategoria e investimeve kapitale ndërsa gjashtë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve). Testimet tonat kanë shpalosur të gjeturat në vijim:

Planifikimi jo adekuat i nevojave për pjesë rezervë nga njësitë kërkuese

Planifikimi i sasisë nuk është bërë si duhet nga njësitë kërkuese. Askund nuk përmendet sasia e duhur e pjesëve rezervë në kërkesën e njëjësive.

Me analizën e kontratave dhe specifikacioneve, vërehet se ato përbëhen nga një varg pjesë rezervë, ku shumica e çmimeve të pjesëve individuale për njësi jep çmimin total, në bazë të cilit është zgjedhur OE i cili ka ofruar çmimin më të ultë.

Në shikim të parë, mund të duket se përzgjedhja është bërë në mënyrë të duhur. Në anën tjetër, mund të shohim se nga 31 artikuj të ofruar nga OE, Hidrodrini ka blerë vetëm dy artikuj, nr.2 dhe nr.26. Në qoftë se bëhet krahasimi i çmimeve të vetëm këtyre dy artikujve, në mes të operatorit ekonomik fitues dhe ofertuesve tjerë, për sasinë e blerë vërehet se Hidrodrini ka paguar me shumë 2,599€

Mallra të pranuar jashtë kushteve të kontraktuara

Në kontratën “Vinkilimi i elektromotorëve të pompave të ujit” janë pranuar mallra jashtë specifikacionit teknik të kontratës.

Çertifikimi i shpenzimeve për këto mallra nuk ka arritur ti identifikoj dhe evitoj parregullsitë e mundshme. Si pasojë këto mallra mund të kenë çmime me të larta në raport me çmimet e tregut.

Parregullsi gjatë kontraktimit dhe menaxhimit me karburante

Ne kemi testuar pesë aktivitete të prokurimit “furnizim me naftë”. Nga këto aktivitete kemi vërejtur parregullsitë në vijim:

- Në katër kontrata të nënshkruara, vërehet se OE fitues nuk kanë ofruar dëshmi mbi pasqyrën e obligimeve të rrymës dhe ujit, sipas kushteve të parapara për nënshkrimin e kontratës. Kjo i bënë OE të papërshtatshëm që të bëjë biznes me kompani publike;
- Sipas kushteve të kontraktuara ishte dashur të bëhen testet për cilësinë e naftës. Në vërejtëm se në katër kontrata të nënshkruara nuk janë bërë këto teste, derisa furnizimet janë realizuar. Kështu mund të pranohen karburante të kualitetit të dobët

duke rrezikuar jo vetëm vlerën e parasë së shpenzuar por edhe dëmtimin e procesit të punës gjatë përdorimit të saj; dhe

- Furnizime me karburante para nënshkrimit të kontratës. Fatura e lëshuar ishte e datës 27 shtator 2010 derisa kontrata ishte nënshkruar një muaj me vonë, konkretisht me 27 tetor 2010.

Konkluzioni

Ne konkludojmë se menaxhimi i shpenzimeve të mallrave dhe shërbimeve përmes prokurimit kishte të meta nga faza e inicimit të aktivitetit të prokurimit e deri në realizimin e kontratave. Dobësitë e cekura gjatë menaxhimit të këtyre shpenzimeve tregojnë kontrolle të dobëta. Kjo mund të dërgoj deri te situata ku mallrat dhe shërbimet të mos jenë të kualitetit të duhur.

Rekomandimi 5

Ne rekomandojmë Bordin e KUR Hidrodrinit të siguroj që:

- Njësitë kërkuese kanë planifikuar nevojat e tyre sipas sasive të kërkuara dhe i kanë dërguar ato te zyrtari i prokurimit;
- Kontrollat e brendshme janë forcuar rreth menaxhimit të procedurave të prokurimit që do të siguronin arritjen e marrëveshjeve efikase të biznesit; dhe
- Tregohet kujdes i shtuar gjatë pranimit të mallrave duke siguruar që sasia dhe kualiteti i tyre është i njëjtë me ato të kontraktuara.

2.2 Blerjet tjera

Në kategorinë e blerjeve tjera janë përfshirë të gjitha blerjet për mallra dhe shërbime të cilat nuk kanë kaluar përmes procedurave të prokurimit. Në këtë kategori ne kemi testuar gjithsej 11 mostra.

Në këtë kategori nuk kemi hasur në ndonjë mangësi.

2.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Shpenzimet e pagave për periudhën e vitit 2010 ishin në vlerë 908,575€ Numri mesatar i punonjësve gjatë kësaj periudhe ishte 182. Prej tyre ne testuam 13 dosje të personelit dhe shpalosëm të gjeturat në vijim:

Nuk mbahen dosje komplete për personelin

Gjatë vitit 2010 dosjet e personelit nuk përmbanin kontratat e punës si dhe informatat e nevojshme siç janë: letërnjoftimi, diplomat e ndryshme, kodin e mirësjelljes dhe vlerësimin e performancës së punëtorëve.

Pas dorëzimit të memos se auditimit në dhjetor të vitit 2010, KUR Hidrodrini ka adresuar pjesërisht këshillën tonë (është adresuar këshilla për vlerësimin e performancës vjetore të punëtorëve).

Mos respektim i procedurave të rekrutimit

Në një rast nuk janë respektuar procedurat e rekrutimit, përkatësisht ka munguar shpallja e konkursit në gazetë dhe nuk ishte formuar komisioni i panelit vlerësues.

Konkluzioni

KUR Hidrodrini nuk ka arritur të vendosë një sistem funksional të kontrollit në këtë Departament. Gjatë rekrutimit të stafit ka munguar transparenca e cila mund të rrezikojë punën e KUR Hidrodrinit.

Rekomandimi 6

Ne rekomandojmë Bordin e KUR Hidrodrinit të siguroj:

- Kompletimin e dosjeve me të gjitha dokumentacionet e nevojshme dhe të bëhet azhurnimi i rregullt i tyre me të gjitha dokumentet e nevojshme; dhe
- Transparencë të plotë gjatë rekrutimit të stafit në mënyrë që stafi i pranuar të ketë kualifikimet e kërkuara.

VI.3 Pasuritë dhe Borxhet

3.1 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Llogaritë e arkëtueshme bruto në fund të vitit 2010 ishin në vlerë 8,671,668€ ndërsa në pasqyrat financiare janë prezantuar sipas vlerës neto 4,174,846€ duke zbritur borxhet e këqija dhe të dyshimta. Gjatë auditimit të kësaj kategorie kemi identifikuar të gjeturat si në vijim:

Provizionimi i të arkëtueshmeve bëhet 60% e vlerës së pa inkasuar

KUR Hidrodrini ka një udhëzim të nxjerrë nga Bordi i Drejtorëve për trajtimin e të arkëtueshmeve. Sipas këtij udhëzimi për çështje të raportimit të arkëtueshmet janë 60% e vlerës së painkasuar. Sistemi aktual i KUR Hidrodrini e gjeneron një raport të vjetërsisë për të arkëtueshmet. Menaxhmenti nuk është i sigurt në saktësinë e këtij raporti dhe si rezultat i provizionon ato me 60%.

Një provizionim i tillë nuk merr për bazë vjetërsinë e kërkesave. Po ashtu kjo përqindje e lartë e provizionimit rezulton me humbje.

Gabime të lëshuara gjate llogaritjeve të provizionimit

Entiteti kishte lëshuar gabime në llogaritjen e provizionimit për llogaritë e arkëtueshme. Në pasqyrat e saj financiare kishte prezantuar borxhet e këqija dhe të dyshimta në vlerë 659,421€ Ne testuam këtë vlerë dhe vërejtëm se sipas politikave kontabël të kompanisë borxhet duhet të ishin 599,542€. Nga kjo rrjedh diferenca prej 59,879€

Pas të gjeturës tonë KUR Hidrodrini i ka korrigjuar pasqyrat e saj financiare.

Konkluzioni

KUR Hidrodrini ka raporte të llogarive të arkëtueshme sipas vjetërsisë, mirëpo provizionimet nuk bëhen duke u bazuar në to. Kjo formë e prezantimit mund të ketë efekte edhe pagesën shtesë të tatimeve dhe ndëshkimeve tjera.

Rekomandimi 7

Ne rekomandojmë Bordin e KUR Hidrodrini që:

- Të siguroj që trajtimi i të arkëtueshmeve si dhe vlerësimi i borxheve të këqija dhe të dyshimta të bëhet në pajtim me SNK-të dhe të korrigjohen në fund të vitit për qëllime të kalkulimit dhe pagesës së tatimeve.

3.2 Stoqet

Në PVF për vitin 2010 KUR Hidrodrini nuk kishte prezantuar stoqe në bilancin e gjendjes. Ndërsa në asqyrën e shpalosjeve kishte prezantuar stoqe në vlerë 833,101€ Ne kemi ekzaminuar dy depo në Pejë dhe kemi vërejtur se kishte stoqe të blera gjatë vitit 2010.

Me pas KUR Hidrodrini i ka korrigjuar stoqet në pasqyra financiare dhe i ka deklaruar më vlerën zero. Ky korrigjim ishte bërë pa vendim të Bordit të Drejtorëve.

Konkluzioni

Nuk mund të vijim në një përfundim që stoqet janë të prezantuara sakët dhe drejtë përderisa në depo përveç produkteve të vjetra ekzistojnë dhe materiale tjera të blera gjatë vitit 2010.

Rekomandimi 8

Ne rekomandojmë Bordin e KUR Hidrodrini që:

- Stoqet duhet të prezantohen drejtë në bilancin e gjendjes si pasuri qarkulluese në vlerën reale të tyre në pajtim me SNK; dhe
- Të gjitha vendimet duhet të kalojnë përmes bordit të drejtorëve që të miratohen për korrigjimin apo vlerësimin e stoqeve.

3.3 Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj

KUR Hidrodrini posedon katër njësi operative siç janë: Pejë, Klinë, Junik dhe Istog. Tek secila njësi ekziston nga një arkëtar. Në bazë të një rregullore të aprovuar nga drejtori financiar është cekur se limiti i arkës për Pejën është 300€ Klinë 200€, Istog 200€ dhe Junik 100€

Ndërsa pagesat lejohen përmes arkës deri në vlerë 100€

Kemi testuar 11 pagesa përmes arkës ku kemi vërejtur dobësi të prezantuara në vijim:

Tejkalime të limitit pagesave përmes parasë së imët

Në menaxhimin e parasë së imët janë vërejtur parregullsi gjatë ekzekutimit të pagesave. Këto i kemi prezantuar në vijim:

- Në katër raste ka ndodhur që janë ekzekutuar pagesa të faturave që kalojnë vlerën 100€
- Në dy raste kishte ndarje të faturave për t'iu shmangur tejkalimit të limitit për pagesë; dhe
- Pagesa e pagave të punëtoreve.

Konkluzioni

KUR Hidrodrini nuk kishte respektuar rregullat e brendshme sa i përket menaxhimit të parasë se gatshme. Mungonte kontrolli gjatë ekzekutimit të pagesave.

Rekomandimi 9

Ne rekomandojmë Bordin e KUR Hidrodrini të siguroj që:

- Të forcohen kontrollet gjatë ekzekutimit të pagesave në pajtim me rregulloren e brendshme duke u bërë pagesat vetëm për paratë e imëta.

3.4 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale

Pasuritë kapitale

Në bilancin e gjendjes pasuritë kapitale (prona, impiantet dhe pajisjet) janë të prezantuara në vlerën neto prej 15,199,229€

Rivlerësimi i Pronës, impianteve dhe pajisjeve është bërë nga vlerësues të pavarur me 01 janar 2007. Bazuar në këtë vlerësim është caktuar vlera fillestare e pasurisë. Nga kjo vlerë është kalkuluar zhvlerësimi për çdo vit.

Ne kemi bërë disa teste lidhur më menaxhimin dhe raportimin e pasurive dhe shpalosëm të gjeturat në vijim:

Mungesë e rregullave mbi menaxhimin e pasurive

KUR Hidrodrini nuk ka ndonjë rregullore për menaxhimin e pasurive po ashtu nuk ekziston përshkrimi i detyrave dhe obligimeve për Zyrtarin e Pasurisë.

Kompania nuk e ka të zgjedhur çështjen e pronësisë

Vlera e prezantuar në Bilancin e Gjendjes nuk reflekton gjendjen reale për arsye se shumë pasuri të KUR “Hidrodrinit” nuk janë në pronësinë e tyre kryesisht toka. Vlera neto e këtyre pasurive është 3,610,098€ (sipas listën këto prona janë në pronësi të: Komunës, KEK-ut, Hekurudhave, Pylltarisë, Private dhe të pa definuar).

Mos ngarkimi i secilit person me inventar në përdorim

Ngarkimi i secilit person me inventarin që e posedon është një praktikë e mirë dhe mundëson kontroll mbi pasuritë. Gjatë auditimit të pasurive është identifikuar se punonjësit nuk janë të ngarkuar me inventar të cilat i kanë në përdorim. Kjo rrezikon keqpërdorimin apo humbjen e pasurisë.

Konkluzioni

KUR Hidrodrini nuk i ka kushtuar rëndësinë e duhur menaxhimit të pasurive të saj. Ajo nuk ka rregulluar kornizën ligjore për menaxhimin e tyre si dhe nuk kishte një sistem të mirë për regjistrimin e pasurive. Problemi tjetër ishte sidomos definimi i pronave (në listën e tyre të pasurisë gjenden vlera të mëdha të pasurive të cilat nuk janë në pronësi të saj).

Rekomandimi 10

Ne rekomandojmë Bordin e KUR Hidrodrinit të siguroj:

- Aprovimin e rregullores më të cilën do të përcaktohen kriteret për menaxhimin dhe raportimin e pasurive;
- Zgjedhjen e çështjes së pronësisë për të gjitha pasuritë që i takojnë. Në të kundërtën pasuritë të cilat nuk janë në pronësinë e saj të largohen nga lista e pasurive; dhe
- Regjistrimin e pasurive duke ngarkuar secilin punonjës me inventarin që e ka në disponim në mënyrë që të zvogëlohen mundësitë për keqpërdorimin e tyre.

VII.Kontrolli mbi menaxhimin

VII.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Sistemi i mirë i kontrollit të brendshëm e ndihmon çdo organizatë buxhetore në arritjen e objektivave të përcaktuara në shfrytëzimin sa me të mirë të parave publike duke siguruar raportim të besueshëm financiar.

Ne kemi kryer disa teste mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm dhe shpalosëm të gjeturat në vijim:

Softweri i kontabilitetit nuk ishte i integruar

Gjatë auditimit është identifikuar se të dhënat e kontabilitetit në tri njësit tjera Klinë, Istog dhe Junik nuk janë të lidhura në serverin kryesor. Shënimet barten pastaj në mënyrë elektronike në qendër ku bëhet azhurnimi i tyre. Si pasojë e bartjes dhe azhurnimit të shënimeve mund të paraqiten gabime të cilat mund të kenë efekte materiale në pasqyrat financiare.

Në mungesë të integritetit të softuerit për tri komunat tjera mund të vijë deri te një raportim jo i mirë.

Anëtari i bordit merret edhe me punë operative

Njëri nga anëtarët e Bordit të Drejtorëve është emëruar nga Qeveria që është në kundërshtim me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike kryesisht neni 17 që përcakton kushtet e kualifikimit dhe përshtatshmërisë profesionale. I njëjti anëtar mbanë njëkohësisht edhe pozitën e Përgjegjës të ekipeve të furnizimit me ujë dhe kanalizim. KUR Hidrodrini kishte paguar të njëjtin për të dy pozitat.

Konkluzioni

KUR Hidrodrini nuk ka arritur të siguroj një sistem të integruar financiar, i cili do të sigurote informata të besueshme për menaxhmentin. Po ashtu nuk kishte dizajnuar sistem të mirë të kontrollit në të cilin do të funksiononte llogaridhënia.

Rekomandimi 11

Ne rekomandojmë Bordin e KUR Hidrodrinit të:

- Shqyrtoj mundësinë e lidhjes së të gjitha njësive operative me sistemin e integruar softuerik. Kjo do të sigurote mbikëqyrje të vazhduar të njësive si dhe do të sigurote informata më të besueshme për menaxhmentin si për nevojat e vendimmarrjes së brendshme ashtu edhe për nevojat e raportimit të jashtëm; dhe
- Të këtë ndarje adekuate të detyrave dhe përgjegjësive duke evituar situatat që mund të shkaktojnë konflikt interesi.

VII.2 Auditimi i Brendshëm

Auditimi i brendshëm është funksion i rëndësishëm i cili duhet të sigurojë menaxhmentin e lartë në lidhje me dizajnin dhe zbatimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm. Aty ku vërehet se kontrollet e brendshme nuk funksionojnë si duhet, auditimi i brendshëm ofron këshilla dhe rekomandime se si ato të përmirësohen.

Ne fushën e auditimit të brendshëm ne testuam procesin prej fazës së planifikimit e deri të faza e adresimit të rekomandimeve.

Departamenti i Auditimit përbehej nga një auditor i brendshëm, i cili kishte përgatitur një plan të auditimit i cili përfshinte këto fusha: prokurimin, vizitat e njëjësive, rrjedha e parasë, pagat, autoparkun, inspektoratin dhe stoqet.

Auditori i brendshëm përpos që kishte implementuar në tërësi planin për vitin 2010, kishte realizuar edhe disa raporte jashtë planit me kërkesë nga komisioni i auditimit siç janë: Raporti për tenderimin e përzgjedhjes së auditorit të jashtëm, Raporti për tenderimin e përzgjedhjes së tenderuesit për sigurime të automjeteve si dhe Raporti për performancën e inkasuesve.

Testimet tona shpalosen të gjeturat në vijim:

Sipas Ligjit të Ndërmarrjeve Publike nr. 03/L-087, çdo Komision i Auditimit do të përbëhet nga tre anëtar. Dy prej tyre duhet të jenë ekspert ose të kanë njohuri adekuate në kontabilitet. Komisioni i auditimit në KUR Hidrodrini përbëhet vetëm nga dy anëtar. Kjo bie në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe praktikat e mira.

Po ashtu edhe përkundër rekomandimeve të auditorit të brendshëm lidhur me përmirësimin e funksionimit të kontrollit, menaxhmenti nuk kishte përgatitur një plan të adresimit të rekomandimeve.

Konkluzioni

Auditimi i brendshëm kishte planifikuar dhe mbuluar fushat të cilat paraqesin rrezik më të lartë. Në raportet e tij janë dhënë rekomandime lidhur me përmirësimin e funksionimit të kontrollit të brendshëm.

Edhe përkundër këtyre rekomandimeve menaxhmenti nuk kishte marrë masa për adresimin e tyre. Si pasojë e kësaj situatë ende kompania nuk ka një sistem funksional të kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi 12

Ne rekomandojmë Bordin e KUR Hidrodrinit të siguroj që:

- Një ose më shumë anëtarë janë caktuar në Komisionin e Auditimit në përputhje me kërkesat ligjore; dhe
- Ti kushtoj rendësi më të madhe adresimit të rekomandimeve të dhëna nga auditori i brendshëm. Në këtë kuptim të përgatisë një plan veprimi të lidhur për kohë të caktuar, me veprime konkrete dhe me përgjegjësi të caktuara për adresimin e tij.

VIII. Konkluzion i Përgjithshëm

Ne vlerësojmë se bordi i drejtorëve të KUR Hidrodrini nuk ka siguruar kontrolle funksionale për të arritur objektivat e caktuara të organizatës.

Pasqyra e shpalosjeve nuk është shumë e qartë (për disa zëra nuk korrespondon me zërat e pasqyrës së bilancit të gjendjes). Regjistri i Pasurisë nuk është i plotë dhe i saktë, si dhe nuk janë prezantuar stoqet në këto pasqyra.

Kompania ka humbje të mëdha të ujit të prodhuar afro 72% dhe nuk kishte bërë analiza të mjaftueshme për shkakun e këtyre humbjeve. Përpos humbjeve nuk kishin inkasim të kënaqshëm edhe për ujin e faturuar. Te menaxhimi i shpenzimeve po ashtu janë vërejtur dobësi të theksuara. Ato nuk janë realizuar në pajtim me kornizën ligjorë të LPP-së. Dosjet e personelit nuk janë komplete si dhe nuk kishte transparence të plotë gjatë rekrutimit të stafit.

Auditori i brendshëm kishte bërë disa rekomandime në raportet e finalizuara të cilat lidhen me disa fusha të menaxhimit financiar dhe menaxhmenti nuk kishte marrë masa lidhur me adresimin e rekomandimeve të tyre.

Këto dobësi na çojnë drejt një konkluzioni të përgjithshëm se Kompania nuk ka një performancë të mirë dhe rrezikon parimet e vijimësisë.

Si rrjedhim, ne rekomandojmë Bordin e KUR Hidrodrini që të:

caktojë menaxherit detyrën për rishikimin e procedurave aktuale të MF/K dhe të krijojë një pako të re të udhëzuesve në MF/K. Kjo pako duhet ti dorëzohet Bordit jo më vonë se 1 shtatori i këtij viti.

Shtojca I. Komentet e KUR Hidrodrini dhe përgjigjja e ZAP-it

Menaxhmentit të KUR Hidrodrinit i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij Raporti. Menaxhmenti i KUR Hidrodrinit ka pranuar të gjeturat dhe konkluzionet tona të paraqitura në Raportin e auditimit mbi Pasqyrat Financiare për vitin 2010 dhe nuk ka dhënë ndonjë koment.

Më tutje, ata janë zotuar se do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një opinion i pakualifikuar jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- (d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. Theksi i çështjeve. Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- (a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. Opinioni i Kualifikuar. Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar.

I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. Opinioni i Kundërt. Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. Mohimi i Opinionit. Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.